



Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 2, pika 2.5, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, në takimin e mbajtur me datën 17 korrik 2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **OBLIGOHEN** të gjithë të licencuarit, të cilët kanë borxhe të papaguara të taksës (ose gjobës), që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, t'i kryejnë të gjitha obligimet ligjore financiare ndaj KPM-së ose të dorëzojnë në KPM marrëveshje valide të lidhur me përmbaruesin privat përmes të cilës dëshmohet se të gjitha obligimet ligjore financiare ndaj KPM-së do të përbushën në afat prej 12 muajve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- II. Dështimi i subjekteve të licencuara për të vepruar në pajtim paragrafin 1 të këtij vendimi do të rezultojë me ndërprerje apo mos-vazhdim të licencës, sipas nenit 30, paragrafi 1, pika 1.6 të Ligjit të KPM-së Nr. 04/L-44.
- III. Të gjithë të licencuarit të cilët janë në proces të ripërtëritjes së licencave janë të obliguar të dëshmojnë së kanë kryer të gjitha obligimet ligjore financiare ose kanë hyrë në marrëveshje me përmbaruesin privat sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, në të kundërtën do të refuzohet ripërtëritja e licencave bazuar në nenin 25 të Ligjit të KPM-së Nr. 04/L-44.
- IV. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.


### A R S Y E T I M

Në bazë të Ligjit të KPM-së Nr. 04/L-44, përkatësisht nenit 3, paragrafi 2, pika 2.5, KPM-ja ka kompetencë të mbledh taksat nga subjektet e licencuara për ofrimin dhe shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale;

Në bazë të Rregullores për Tarifën Vjetore për Licencë KPM-2017/06, të licencuarit janë të obliguar që të paguajnë tarifën për licencë jo me vonë së deri me datën 30 qershor të vitit respektiv;


Duke u bazuar në të dhënat financiare të KPM-së, vërehet se një numër i konsiderueshëm i të licencuarve të KPM-së në mënyrë të vazhdueshme kanë dështuar t'i kryejnë obligimet ligjore financiare ndaj KPM-së, fakt ky i cili ka ndikuar në grumbullimin dhe rritjen e borxheve ndaj KPM-së;

Prandaj KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

  
Jeton Mehmeti  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



19.07.2023  
Data



### **Vendimi i dërgohet:**

- Të licencuarve të cilët kanë obligime financiare;
- Arkivit të KPM-së.